



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN
KËSHILLI BASHKIAK

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK POLIÇAN

Miraturar me Vendim Nr.14, Datë 20.02.2020

KRYETARI I KËSHILLIT

MIMOZA LULAJ



RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT
BASHKIAK POLIÇAN

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i rregullore

Kjo Rregullore përcakton rregullat e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Këshillit Bashkiak Poliçan, marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të Këshillit, strukturave të Këshillit, marrëdhëniet me organin egzekutiv të Bashkisë dhe me organet që verifikojnë ligjshmërinë e akteve të Këshillit Bashkiak Poliçan. Në këte rregullore përcaktohet: mënyra, drejtimi dhe funksionimi i punës së Këshillit Bashkiak Poliçan.

Neni 2
Baza ligjore

Baza ligjore në hartimin e kësaj Rregullore janë aktet e më poshtme:

- Ligji nr. 8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 8137 datë 31.07.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.
- Ligji nr. 8548 datë 11.11.1999 “Për Ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore”.
- Ligji nr. 139 datë 17.12.2015 “Për Vetë-Qeverisjen Vendore”.
- Ligji nr. 115 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9970 datë 24.7.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”.
- Ligji nr. 146 datë 30.10.2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.
- Ligji nr. 119 datë 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit”.
- Ligji nr. 8480 datë 27.5.1999, “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”.
- Ligji nr. 44 datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr.107 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”.
- Ligji nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Ligji nr. 8756 datë 26.3.2001 “Për Emergjencat Civile”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 114 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.
- Ligji nr. 10 296 datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.
- Ligji nr. 9869 datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”.

Ligji nr. 107 datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.
Ligji nr. 68 datë 27.04. 2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.
Ligji nr. 138 datë 17.12. 2015 “Për Garantimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrojnë Funksione Publike”.

Neni 3

Stema dhe vula e Këshillit Bashkiak

Këshilli përdor stemën e Republikës së Shqipërisë dhe vulën zyrtare, sipas legjislacionit në fuqi. Këshilli Bashkiak, bazuar në traditën dhe historinë e qytetit, miraton me vendim Stemën e Bashkisë. Stema e Bashkisë përdoret në mjediset e Bashkisë dhe në mjediset e punës së Këshillit, në mjediset publike, në dokumente e akte të brendshme të Këshillit, në korrespondencën e Këshillit me të tretë, në botime e publikime e Këshillit, ose në veprimtaritë të cilat organizohen nga Këshilli.

Neni 4

Parimet e funksionimit të Këshillit

1. Parimet e funksionimit të Këshillit janë:

Interesi publik - Këshilltarët duhet të veprojnë vetëm në bazë të interesit publik dhe jo atij personal. Ata nuk duhet të përdorin pozicionin si këshilltar për të përfituar për veten. Këshilltari/jaështë ruajtësi i interesit publik dhe prandaj sjellja, veprimet dhe vendimet e tij duhet të reflektojnë në çdo rast këtë përgjegjësi.

Integriteti - Këshilltarët duhet të shmangin vënien e vetes nën detyrime ndaj njerëzve dhe organizatave që mund të përpiqen në mënyrë të papërshtatshëm t'i influencojnë ata në punën dhe vendimet e tyre. Këshilltarët duhet të mos veprojnë ose marrin vendime me qëllim që të marrin përfitime financiare ose materiale për vetveten, familjen e tyre ose miqtë e tyre. Ata duhet të deklarojnë çdo konflikt interesi dhe lidhje apo marrëdhënie me njerëz jo të përshtatshëm.

Objektiviteti - Këshilltarët duhet të veprojnë dhe të marrin vendime në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe në bazë të meritës, duke përdorur evidencat më të besueshme dhe pa diskriminime apo paragjykime. Këshilltarët mund të marrin në konsideratë këshillat profesionale të kolegeve, apo pikëpamjet e grupeve të tyre politike, por në fund është përgjegjësia e tyre për të marrë vendimin dhe votuar me objektivitet për çështjet e shtruara për shqyrtim në Këshill.

Përgjegjshmëria - Këshilltarët janë përgjegjës ndaj zgjedhësve të tyre dhe publikut në përgjithësi, për sjelljet, veprimet dhe vendimet e tyre..

Transparenca - Këshilltarët duhet të veprojnë dhe të marrin vendime në mënyrë të hapur dhe transparente. Informacioni nuk duhet t'i mbahet publikut, vetëm nëse ka arsye të qarta dhe ligjore për ta bërë këtë.

Ndershmëria - Këshilltarët duhet të jenë të ndershëm dhe të besueshëm gjatë ushtrimit të funksionit të tyre.

Lidershipi - Këshilltarët duhet të demonstrojnë këto parime në sjelljen e tyre. Ata duhet të promovojnë në mënyrë aktive dhe të mbeshtesin në mënyrë të qëndrueshme këto parime, si dhe të jenë të gatshëm të sfidojnë sjelljet që bien ndesh me këto parime, kudo dhe kurdoherë që të ndodhin.

Barazia dhe mosdiskriminimi – Këshilltarët duhet të veprojnë dhe të marrin vendime duke mundësuar akses dhe mbështetje të barabartë ndaj qytetarëve në shërbime nëpërmjet integritit gjinor dhe gjithëpërfshirjes në programet e Bashkisë.

Neni 5 Përkufizime

Në këte rregullore emrat e mëposhtëm kanë këto kuptime/shpjegime:

“**Ligj Organik**”, nënkupton ligjin për “ Vetëqeverisjen Vendore”Nr.139/2015

“**Statut**”, nënkupton aktin më të lartë juridik të miratuar nga Këshilli Bashkak Polican.

“**Këshilli Bashkiak**”, është Organi përfaqësues i Bashkisë Polican, që ushtron kompetencat e tij nëpërmjet vendimeve, urdhëresave dhe urdhrave.

Këshilltar: Këshilltar i mandatuar dhe në detyrë i Këshillit të Bashkisë Polican.

“**Kryetari i Këshillit**”, Kryetari i Zgjedhur i Këshillit Bashkiak Polican.

“**Sekretari i Këshillit**”, Sekretari/ja i/e Këshillit Bashkiak Polican.

“**Kryesia e Këshillit**”, Organ drejtues i përbërë nga Kryetari , N/kryerari dhe kryetarët e grupeve politike të Këshillit Bashkiak.

“**Komision**”, nënkupton komisionet e përhershme dhe komisionet e tjera, të ngritura nga Këshilli Bashkiak në pajtim me Ligjin, Statutin e Bashkisë dhe këtë Rregullore që përmban kompetencat e këtyre komisioneve.

“**Komision i Përhershëm**”, Komision me Këshilltarë Bashkiak i cili themelohet me vendim të Këshillit dhe ka si funksion diskutimin, debatimin, hetimin dhe rekomandimin të një veprim që duhet të marrë Këshilli për të marrë një vendim në ushtrim të kompetencave të dhëna me ligj, komision i cili funksionon gjatë gjithë mandatit të Këshillit.

“**Komision i Përzier**”, Quhet ai Komision i përbërë nga Këshilltarë Bashkiak nga më shumë se një komision i përhershëm, apo një komision i përbërë nga këshilltarë dhe anëtarë të komunitetit dhe/apo përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare.

“**Komision i Përkohshëm**”, Komision me Këshilltarë Bashkiak i cili themelohet me vendim të Këshillit për një qëllim të veçantë dhe ka si funksion diskutimin, debatimin, hetimin dhe rekomandimin për veprim që duhet të marrë Këshilli për të marrë vendime në ushtrim të kompetencave të dhëna me ligj, komision i cili funksionon për një periudhë të përcaktuar në vendimin e Këshillit deri në realizimin e qëllimit të veçantë për të cilin është ngritur.

“**Kryetari i/e Komisionit**”, nënkupton Kryetarin e zgjedhur nga anëtarët e Komisionit të caktuar të Këshillit Bashkiak.

“**Kuorum**”, Shumica e të gjithë Këshilltarëve, duke përjashtuar nga numërimi vendet e mundshme bosh në Këshill në momentin e llogaritjes së Kuorumit apo Këshilltarin i cili nuk merr pjesë në mbledhje për arsye të konfliktit të interesit, shumicë e cila e bën të vlefshme për procedim një mbledhje zyrtare të Këshillit.

“**Këshillimet me Bashkësinë**”, Përfshijnë takime të inicuar nga Bashkia/ Këshilli Bashkiak, të kërkuara nga ligji apo jo , me grupe banorësh, me specialistë, me institucionet dhe organizatat jo-qeveritare të interesuara të thirrura nga Këshilli dhe Komisioni i Përhershëm i Këshillit

Bashkiak, sipas rasteve të kërkuara nga legjislacioni, për çështjen e projektakte që ato kanë shqyrtim., apo për rastet e marrjes së nismës për organizimin e referendumit vendore.

Konsultim Publik: Tërheqja e mendimeve, sygjërimeve dhe vërejtjeve të publikut për përmbajtjen dhe përmirësimin e projektaktit, nga momenti i publikimit deri në miratimin përfundimtar nga Këshilli Bashkiak.

“Qeverisje vendore”, proceset politike dhe institucionale përmes të cilave merren dhe zbatohen vendimet e Këshillit Bashkiak për drejtimin dhe rregullimin e çështjeve vendore, procese të cilat janë pjesëmarrëse, llogaridhënëse, transparente, eficente, përfshirëse, dhe që ndërmirren në zbatim të Ligjit.

“Akt”, Çdo vendim, urdhër, urdhëresë, rezolutë, kontratë apo çdo rregullim apo veprim tjetër që ka efektin e të sipërpërmendurave, i shqyrtuar dhe miratuar sipas procedurave, normave, standarteve, kritereve të miratuara nga Ligji, dhe rregullorja e Këshillit Bashkiak, dhe për të cilën ka votuar shumica e domosdoshme e Këshilltarëve në një mbledhje zyrtare dhe të vlefshme të Këshillit.

“Rregullim”, është e drejta për të përcaktuar rregulla të përgjithshme dhe normative sjelljeje, si dhe standarde të detyrueshme në përputhje me ligjin.

“Bashkia”, Bashkia Poliçan

“Barazi gjinore”, është pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe e meshkujve në të gjithat fushat e jetës, pozita e barabartë ndërmjet tyre, mundësi e shanse të barabarta, për të gëzuar të drejtat dhe për të përmbushur detyrimet në shoqëri, duke përfutur njëlloj nga arritjet e zhvillimit të saj.

“Buxheti i Bashkisë”, është tërësia e të ardhurave, financimeve dhe shpenzimeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore, miratuar nga Këshilli Bashkiak dhe përbëhet nga programi buxhetor afatmesëm dhe buxheti vjetor i Bashkisë.

“Buxhetor afatmesëm i Bashkisë”, pasqyron mënyrën e krijimit dhe të shpërndarjes së burimeve financiare afatmesme për një periudhë tre (3) vjeçare, dhe bën të zbatueshëm planin strategjik të zhvillimit të Bashkisë.

“Mbledhje e Këshillit”, është çdo grumbullim apo komunikim i njëkohshëm i shumicës së anëtarëve të Këshillit, në të njëjtën orë dhe sallë apo nepërmjet mjeteve elektronike, të Këshilltarëve të mandatuar të Këshillit Bashkiak, e thirrur sipas Ligjit dhe kësaj rregullore, ku Këshilltarët dëgjojnë, diskutojnë, shqyrtojnë dhe ndërmarrin veprime apo marrin vendime, vetëm për çështje publike në ushtrim të funksioneve dhe kompetencave që i janë dhënë Këshillit me ligj.

“Mbledhje Organizative/konstituimit”, mbledhja e parë e Këshillit Bashkiak mbas zgjedhjeve vendore, ku bëhet mandatimi i Këshilltarëve të sapozgjedhur dhe zgjidhet Kryetari, Z/Kryetari i Këshillit Bashkiak, përfaqësuesi në këshillin e qarkut dhe/ ose anëtarësine e Komisioneve të përhershme të Këshillit.

“Mbledhje Emergjence”, është një mbledhje e Këshillit e cila mbahet në rrethana të papritura dhe emergjence gjatë proçrdimeve të se cilës shqyrtohen dhe diskutohen çështje emergjente për të cilat nuk mund të pritet, dhe ku ndërmirren veprime të menjëhershme nga Këshilli.

“Shumica Absolute”, shumica, 50% +1, e numrit të përgjithshëm të të gjithë Këshilltarëve Bashkiakë/Anëtarëve.

“Shumica e Cilësuar”, shumicë e cila është cilësuar në ligj apo rregullore të Këshillit Bashkiak, p.sh 1/3 apo 3/5 e të gjithë Këshilltarëve Bashkiak apo e Këshilltarëve të pranishëm në mbledhje.

“Shumicë e Thjeshtë”, numri 50% +1 të këshilltarëve të pranishëm, shumicë kjo e mjaftueshme për mbajtjen e një mbledhje apo marrjen e një vendimi nga Këshilli sipas kërkesave të Ligjit apo kësaj rregullore.

Neni 6 **Organet e Qeverisjes Vendore të Bashkisë Poliçan**

1. Në Bashkinë Poliçan funksionojnë:
 - a) Këshillit Bashkiak si organ përfaqësues i Bashkisë.
 - b) Kryetari i Bashkisë si organ ekzekutiv i Bashkisë.
2. Në përputhje me ligjin, si dhe për interes publik, organet e Bashkisë Poliçan, nxjerrin vendime, urdhëresa dhe urdhëra, për bashkërendimin e veprimeve në Njësitë Administrative, në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Neni 7 **Statusi i Këshillit Bashkiak Poliçan**

1. Këshillit Bashkiak, gëzon të drejtat, kryen funksionet dhe ushtron përgjegjësitë e përcaktuara për bashkitë në Kushtetutë, në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse.
2. Këshillit Bashkiak ndërmerr nisma në interes publik vendor të Bashkisë Poliçan, për çdo çështje që nuk ndalohet me ligj, ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj, një organi tjetër shtetëror.
3. Këshillit Bashkiak bashkëpunon me organet e tjera të qeverisjes vendore dhe të qeverisjes qendrore, për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta në dobi të komunitetit.

KREU II

ORGANIZIMI, KOMPETENCAT DHE DETYRAT E KËSHILLIT BASHKIAK

Neni 8 **Numri dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit**

1. Këshillit Bashkiak Poliçan përbëhet nga 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë, prej të cilëve zgjidhet një Kryetar dhe një Zv/Kryetar i Këshillit.
2. Anëtarët e Këshillit Bashkiak, zgjidhen sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 9 **Mbledhja e parë e Këshillit Bashkiak (Konstituimi)**

1. Mbledhja e parë e Këshillit Bashkiak, zhvillohet duke u bazuar në nenin 48 të ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.
2. Këshilli Bashkiak zhvillon mbledhjen e tij të parë, jo më vonë se 20 ditë nga shpallja e rezultatit përfundimtarë të zgjedhjeve për pushtetin vendor nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
3. Mbledhja e parë e Këshillit thirret nga Sekretari i Këshillit Bashkiak dhe në mungesë të tij, nismën për thirrjen e mbledhjes së parë e merr Prefekti i Qarkut të Beratit. Data për mbajtjen e Mbledhjes së Parë të Këshillit përcaktohet nga Sekretari, në konsultim të ngushtë me Kryetarin në detyrë dhe Kryetarin e sapozgjedhur të Bashkisë, dhe i njoftohet Prefektit.
- Njoftimi për këtë mbledhje bëhet publik nëpërmjet mediave, afishimit publik dhe publikimit në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.
4. Në rast se Sekretari i Këshillit apo Prefekti nuk e ushtrojnë të drejtën e thirrjes së Mbledhjes së parë të Këshillit, dhe për këtë arsye mbledhja e Këshillit nuk mbahet brenda afatit 20 ditor të parashikuar, atëherë Këshilli mblidhet vetë brenda 10 ditëve.

5. Mbledhja e parë e Këshillit është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të tij, të shpallur fitues nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Nëse mbas thirrjes së parë të mbledhjes së parë, nuk mblidhen më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit sipas listës së Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbledhja nuk zhvillohet dhe ajo thirret nga i njëjti subjekt që ka bërë thirrjen e parë, çdo tri ditë më vonë, por nuk thirret më shumë se tri here. Në rastet kur edhe pas tri herë thirrje nuk sigurohet pjesmarrja e kërkuar, Këshilli konsiderohet i shpërndarë.

6. Mbledhja e parë e Këshillit Bashkiak, deri në zgjedhjen e Kryetarit të tij, drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë, i pranishëm në mbledhje.

7. Veprimet në mbledhjen e parë të Këshillit Bashkiak:

- a. Zgjedhet Komisioni i Mandateve
- b. Miratohen mandatet e Këshilltarëve
- c. Këshilltarët e mandatuar bëjnë betimin
- d. Zgjidhet Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit
- e. Zgjidhen anëtarët që do të përfaqësojnë Këshillin Bashkiak në Këshillin e Qarkut
- f. Bëhet shpallja e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të bashkisë dhe më pas Kryetari i Bashkisë bën betimin
- g. Kryetari i Bashkisë mban fjalën përshëndetëse përpara Këshillit

8. Këshilli konstituohet pas vërtetimit të mandateve të më shumë se gjysmës të anëtarëve të Këshillit.

Neni 10

Rendi i ditës i mbledhjes së parë

1. Në mbledhjen e parë të konstituimit të këshillit bashkiak bëhet zgjedhja e organeve drejtuese e përfaqësuese:
 - a) Zgjedhja e komisionit të verifikimit të mandateve .Ky komision përbëhet nga 3(tre) këshilltarë, të cilët zgjidhen me votim të hapur;
 - b) Verifikohen dhe miratohen mandatet e antarëve të këshillit bashkiak;
 - c) Zgjedhja e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të këshillit bashkiak;ç Zgjidhen antarët që do të përfaqësojnë Këshillin Bashkiak në Këshillin e Qarkut Berat dhe pajisen me mandatin e përfaqësimit. Përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak në Këshillin e Qarkut, në jo më pak se 50% të tyre, duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar.
2. Pas verifikimit të mandateve nga Komisioni i Mandateve, këshilltarët me mandat të vlefshëm bëjnë këtë betim para Këshillit:

“Beto hem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Beto hem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Polican dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.
3. Teksti i betimit lexohet nga kryesuesi i mbledhjes dhe këshilltarët ftohen të ngrihen në këmbë dhe të deklarojnë “Beto hem”. Çdo këshilltar nënshkruan tekstin e betimit. Këshilltari që mungon në mbledhjen e parë të Këshillit, betohet në mbledhjen e radhës së Këshillit. Këshilltari, që nuk pranon të bëjë dhe të nënshkruajë betimin, konsiderohet se jep dorëheqjen nga mandati i këshilltarit dhe atij nuk i jepet mandati.
4. Këshilli konstituohet pas vërtetimit të mandateve të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij.
5. Këshilli Bashkiak ushtron funksionet e tij nga data e konstituimit, deri në krijimin e këshillit të ri pasardhës.

Neni 11

Mandati i Kryetarit të Bashkisë

Shpallja e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë dhe betimi i tij bëhet në mbledhjen e parë të Këshillit Bashkiak dhe pas konstituimit të Këshillit. Kryetari i sapozgjedhur i Këshillit pas shpalljes së, vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë, lexon formulën e betimit, sipas formulës së përcaktuar në nenin 50 të Ligjit 139/2015.

“Beto hem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e Kryetarit të Bashkisë dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Beto hem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Polican dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.

Kryetari i Bashkisë ngrihet dhe qëndron në këmbë gjatë leximit të formulës së betimit dhe deklaron me zë të lartë “Beto hem” pas mbarimit të leximit të formulës, dhe më pas e nënshkruan atë.

Neni 12

Mandati i Këshilltarit

1. Dhënia dhe heqja e mandatit të këshilltarit bëhet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit, për shkaqe të parashikuara në ligj.
2. Këshilltari nuk voton për mandatin e tij.
3. Mandati i Këshilltarit mbaron përpara afatit kur:
 - ndryshon vendbanimin dhe regjistrohet si banor jashtë territorit të bashkisë Polican ;
 - jep dorëheqjen;
 - krijohen kushte të papajtueshmërisë, të përcaktuara në nenin 47 të Ligjit nr. 139/2015;
 - mandati, nga ana e tij është marrë në mënyrë të kundërligjshme;
 - humbet zotësinë për të vepruar me vendim gjykate;
 - vdes;
 - nuk merr pjesë në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6-mujore;
 - dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim gjykate të formës së prerë;
 - këshilli shpërmdahet nga Këshillit të Ministrave.
4. Mbarimi i mandatit para kohe i këshilltarit, deklarohe me vendim të Këshillit Bashkiak, me propozim të Komisionit të Mandateve.
5. Heqja e mandatit të këshilltarit bëhet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.
6. Zëvendësimi i vakancës kryhet sipas rregullave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, pas procedurave ligjore të ndjekura nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.
7. Këshilltari i ri, si rregull është pjesë e komisioneve ku ka qene këshilltari i zëvendësuar.

Neni 13

Papajtueshmëria e funksionit të Këshilltarit

1. Funksioni i Këshilltarit është i papajtueshëm me:
 - a) funksionin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të bashkisë;
 - b) funksionin e sekretarit të këshillit bashkiak;
 - c) funksionin e nëpunësit të administratës së bashkisë përkatëse dhe institucioneve në varësi të saj;
 - ç) funksionin e deputetit;
 - d) funksionin e ministrit;
2. Një person nuk mund të zgjidhet në të njëjtën kohë në më shumë se një Këshill Bashkiak.
3. Nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit Këshill personat e lidhur: bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehri e vjehrra me nusen e dhëndrin.
4. Nuk mund të punojë në administratën e Bashkisë ku ai është Këshilltar Bashkiak.

Neni 14

Të drejtat e këshilltarit

1. Këshilltari kryen funksionin me shpërblim mujor të barabartë me 10 % të pagës mujore të kryetarit të bashkisë.
2. Punëdhënësi detyrohet të lejojë anëtarin e këshillit bashkiak të shkëputet nga puna për të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak, komisioneve të tij apo aktivitete të organizuara prej Këshillit Bashkiak.
3. Me kërkesën e tij, këshilltari informohet dhe i vihet në dispozicion në çdo kohë, nga kryetari i bashkisë/administrate, çdo dokumentacion i lidhur me Bashkinë.
4. Këshilltari ka të drejtën e kualifikimit profesional, sipas programit të miratuar nga këshilli. Financimi për këto raste bëhet sipas rregullave të legjislacionit në fuqi.

Neni 15

Konflikt interesi

1. Këshilltari nuk merr pjesë në shqyrtimin dhe miratimin e project-aktit, të këshillit, kur ai bashkeshorti, prindërit, fëmijët, vëllezërit, motrat, vjehri, vjehrra, dhëndri e nusja e tij, kanë interes pasuror, ose çdo interes tjetër në çështjen që diskutohet në këshill.
2. Në çdo rast konflikt interesash, zbatohen dispozitat skualifikuese të parashikuara në kodin e Proçedurave Administrativeve edhe sipas proçedurave të përcaktuara në nenin 52 të ligjit për "Vetëqeverisjen Vendore"

Neni 16

Mbledhjet e Këshillit Bashkiak

1. Këshilli Bashkiak ushtron funksionet e tij nga krijimi deri në konstituimin e këshillit të ri, sipas proçedurave të përcaktuara në nenin 53 të ligjit për "Vetëqeverisjen Vendore".
2. Mbledhjet e radhës së Këshillit Bashkiak zhvillohen si rregull, sipas përcaktimit që bën vetë Këshilli, por jo më pak se një herë në muaj.
3. Këshilli mbledhet jashtë radhe me kërkesë të:

- a. Kryetarit të Bashkisë;
 - b. 1/3 së Këshilltarëve;
 - c. kërkesës së motivuar të Prefektit, për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.
4. Thirrja për mbledhjen e Këshillit, bëhet nga Kryetari i Këshillit dhe në mungesë të tij nga Zëvendëskryetari. Njoftimi për zhvillimin e Mbledhjes së Këshillit bëhet nga Sekretari, jo më pak se pesë (5) ditë para datës së zhvillimit të saj. Njoftimi përmban datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës.
5. Rendi i ditës miratohet nga Këshilli.
6. Në periudhën nga data e zgjedhjeve e deri në konstituimin e Këshillit të ri, Këshilli i mëparshëm Bashkiak ushtron kompetenca të kufizuara dhe merr vendime vetëm në raste të situatave emergjente.
7. Mbledhja e këshillit bashkiak quhet e vlefshme kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të Këshillit, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë tjetër për marrjen e vendimeve, sipas përcaktimeve në nenin 55 të ligjit për "Vetëqeverisjen Vendore".
8. Kur Këshilli nuk mbledhet, për shkak të mungesës së anëtarëve të tij gjatë tre muajve, nga data e mbledhjes së fundit të tij, Këshilli quhet i vetëshpërndarë. Vetëshpërndarja, pasohet me zgjedhje të reja për Këshillin dhe Sekretari i Këshillit brënda 10 ditëve nga përfundimi i afatit tre mujor, njofton Prefektin.
9. Mbledhjet e këshillit pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes. Mënyra e mbajtjes së procesverbalit dhe e vërtetimit të tij përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 17

Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak

1. Këshilli bashkiak, bazuar në nenin 54 të ligjit për "Vetëqeverisjen Vendore", ka këto detyra dhe kompetenca:
- a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
 - b) zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata;
 - c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit bashkiak;
 - ç) miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;
 - dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;
 - e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;
 - ë) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të bashkisë;
 - f) vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
 - g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;
 - gj) vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë;
 - h) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;

- i) zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre, duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar;
- j) vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 49 të këtij ligji;
- k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;
- l) vendos për simbolet e bashkisë;
- ll) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë;
- m) jep tituj nderi dhe stimuj;
- n) vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit, me të cilin bëhet ky delegim te bashkia.

KREU III. KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK

Neni 18 Kryesia e Këshillit Bashkiak

1. Kryesia e Këshillit përbëhet nga:
Kryetari,
Z/Kryetari i Këshillit,
Kryetarët e grupeve të këshilltarëve.
2. Mbledhja e kryesisë së Këshillit thirret dhe drejtohet nga Kryetari i Këshillit. Mbledhja e kryesisë së Këshillit për çështje emergjente zhvillohet të paktën jo më vonë se 24 orë para mbledhjes së Këshillit.
3. Kryesia, kur e gjykon të nevojshme, fton në mbledhje të zgjeruar të saj, drejtuesit e grupeve të Këshilltarëve si dhe përfaqësuesin e organit ekzekutiv.
4. Kryesia e Këshillit, është organ konsultativ që kujdeset për mbarëvajtjen e punës së Këshillit, gjatë dhe midis dy mbledhjeve të tij.
5. Kryesia përgatit projekt-tematikën e çështjeve që do të shqyrtojë Këshilli Bashkiak në periudha vjetore, 3 mujore, mbi bazë të propozimeve të organit ekzekutiv, të grupeve të Këshilltarëve, të komisioneve dhe e paraqet për miratim në mbledhjen e tij.
6. Kryesia, mbikqyr dhe ndihmon mbarëvajtjen e veprimtarisë së komisioneve të përhershme, dhe të përkohshme të Këshillit.
7. Kryesia, në konsultim me drejtuesit e grupeve të Këshilltarëve përcakton përfaqësuesit në marrëdhëniet me këshilla bashkiakë të tjerë, brënda dhe jashtë vëndit dhe njofton Këshillin Bashkiak në mbledhjen e afërt të tij.
8. Kryesia e Këshillit, mund të rekomandojë që Këshilli Bashkiak, të ketë të përcaktuar linjën e vetë buxhetore gjatë miratimit të buxhetit vjetor, ku të përcaktojë shpenzimet e veta në mbështetje të aktiviteteve të tij, si ato të konsultimeve me publikun, për mbështetje teknike e ekspertizë, për shpenzime të tjera operative dhe investime në përmirësimin e kushteve të punës dhe jo vetëm.

Neni 19

Kryetari i Këshillit Bashkiak

1. Kryetari i Këshillit Bashkiak, zgjidhet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.
2. Kryetari i këshillit kryen këto detyra:
 - Thërret mbledhjen e këshillit, në përputhje me nenin 53 të ligjit për "Vetëqeverisjen Vendore";
 - Drejton mbledhjet e këshillit, në përputhje me rregulloren e tij;
 - Nënshkruan aktet që nxjerr këshilli;
 - U bën të njohur këshilltarëve project-aktet që i paraqiten Këshillit;
 - Përfaqëson Këshillin në veprimtari, cermoni apo aktivitete të ndryshme të qytetit;
 - Shpall rendin e ditës, për mbledhjen e ardhshme të Këshillit dhe njofton zyrtarisht Kryetarin e Bashkisë, për paraqitjen e materialeve sipas tematikës së miratuar;
3. Kryetari i Këshillit, ka detyrë të kujdeset për të drejtat e këshilltarëve, duke garantuar ushtrimin efektiv të funksionit të tyre, si dhe të zbatojë me perkpikmëri interpretimin korrekt të kësaj rregulloreje
4. Kryetari kujdeset për marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Kryetarin e Bashkisë, Drejtoritë dhe Ndërmarrjet e varësisë ose me sipërmarrje në Bashki;
5. Kryetari drejton mbledhjen e kryetarëve të grupeve dhe kur e sheh te nevojshme therret dhe kryetarët e komisioneve për probleme të mbarëvajtjes së Këshillit Bashkiak;
6. Kryetari merr dhe lexon korrespondencën që i dërgohet Këshillit dhe bën delegimin përkatës për shqyrtim të mëtejshëm të çështjes;
7. Kryetari kryen detyra të tjeratë caktuara nga këshilli ose të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 20

Shkarkimi i Kryetarit të Këshillit Bashkiak

1. Kryetari i Këshillit shkarkohet për shkelje të rënda të ligjit, për paaftësi, sjellje e qëndrime që vijnë në kundërshtim me pozitën dhe figurën e Kryetarit.
2. Propozimi për shkarkimin e tij, bëhet me shkrim nga të paktën 1/3 e anëtarëve të Këshillit.

Neni 21

Zv/Kryetari i Këshillit Bashkiak

1. Zv/Kryetari i Këshillit Bashkiak, zgjidhet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit. Propozimi për shkarkimin e tij bëhet nga të paktën një e treta (1/3) e anëtarëve të Këshillit.
2. Në mungesë të Kryetarit detyrat e tij i ushtron Zv/Kryetari, i cili drejton mbledhjen e Këshillit dhe nënshkruan aktet e miratuara prej tij, bazuar në pikën 3 të nenit 56, të ligjit "Për Vetëqeverisjen Vendore";

Neni 22

Sekretari i Këshillit Bashkiak

1. Sekretari i Këshillit emërohet nga Këshilli Bashkiak, në bazë të propozimit të Kryetarit të Këshillit, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit.

2. Sekretari i këshillit bashkiak është përgjegjës për:
 - a) Mbajtjen e dokumenteve zyrtare të këshillit;
 - b) Ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve, sipas rendit të ditës;
 - c) Nofitim për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit;
 - ç) Shpalljen dhe publikimin e njoftimeve e të akteve të nxjerra nga këshilli bashkiak;
 - d) Përgatitjen e seancave të këshillimit me bashkësinë;
 - dh) Mbikëqyrjen e respektimit të rregullores së funksionimit të këshillit.
 - e) Vërtetimin e saktësisë dhe të nënshkrimit të protokollit të mbledhjeve të Këshillit.
3. Roli i Sekretarit të Këshillit Bashkiak, është elementi kyç ndërlidhës, për të krijuar marrëdhënie sa më korrekte midis organit ekzekutiv të Bashkisë dhe organit përfaqësues të Këshillit.
4. Sekretari i Këshillit merr detyra specifike nga Këshilli, bashkëpunon me Kryetarin e Bashkisë dhe e vë në dijeni atë me gojë ose me shkrim për problemet që lindin.
5. Ndhmon Kryetarin gjatë zhvillimit të mbledhjeve të Këshillit.
6. Sekretari i Këshillit mban regjistrin elektronik të vendimeve, si dhe publikimin e tyre.
7. Shkarkimi i Sekretarit të këshillit mund të propozohet nga Kryetari i Këshillit ose nga 1/3 e anëtarëve të këshillit, vetëm pas verifikimit për shkelje të rënda të ligjit në fuqi.
8. Sekretari i Këshillit Bashkiak kryen çdo funksion tjetër që i caktohet nga Këshilli.

Neni 23

Votimi për zgjedhjen e Kryetarit, Zv/Kryetarit dhe Sekretarit të Këshillit

1. Votimi për zgjedhjen e Kryetarit, Zv/Kryetarit dhe Sekretarit të Këshillit bëhet i fshehtë. Në votimet për kryetarin, zëvendës-kryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar e të gjithë anëtarëve të Këshillit (50%+1), votimi ribëhet midis dy kandidaturave që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave.
2. Në këtë rast fitues shpallet kandidati që ka marrë numrin më të madh të votave "Pro".
3. Në rast se sërish votat janë të barabarta, do të kryehet një votim i dytë. Kur edhe në votimin e dytë ka barazi të votave, vendimi do të shtyhet për mbledhjen tjetër.
4. Drejtuesi i mbledhjes kërkon propozime për anëtarë të komisionit të votimit. Komisioni i votimit përbëhet prej tre (3) Këshilltarësh. Anëtarët e komisionit zgjidhen me votim të hapur.
 - a) Kandidatët për Kryetar, Zv/Kryetarët dhe Sekretar të Këshillit nuk mund të jenë anëtarë të komisionit të votimit.
 - b) Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e drejtuesit të seances është vendimtare.
5. I njëjti komision votimi vlen edhe për rastet e tjera, kur ka procedurë të votimit të fshehtë.
6. Kryetari i zgjedhur i Këshillit Bashkiak merr drejtimin e mbledhjes, menjëherë pas shpalljes së rezultatit të votimit për Kryetar të Këshillit nga Komisioni i Votimit.

Neni 24

Lirimi dhe Shkarkimi, i Kryetarit, Zv/Kryetarit dhe Sekretarit të Këshillit

1. Kryetari, Zv/Kryetari, dhe Sekretari i Këshillit, lirohen nga detyra me vendim të Këshillit, kur japin dorëheqjen.

2. Të paktën një e treta (1/3) e anëtarëve të Këshillit, mund të kërkojë shkarkimin e Kryetarit, Zv/Kryetarit apo Sekretari i Këshillit.
3. Kërkesa paraqitet zyrtarisht me shkrim dhe nënshkruhet nga të gjithë propozuesit, duke dhënë edhe arsyet e propozimit.
4. Kërkesa shqyrtohet në mbledhjen e parë të Këshillit Bashkiak.
5. Votimi për këtë kërkesë bëhet i fshehtë. Propozimi quhet i miratuar kur kanë votuar "Pro" propozimit, jo më pakë se shumica e të gjithë anëtarve të Këshillit (50%+1).

KREU IV.

GRUPIMET E KËSHILLTARËVE

Neni 25

Grupet e Këshilltarëve

1. Këshilltarët mund të grupohen në përputhje me orientimin e tyre politik.
2. Këshilltari mund të marrë pjesë vetëm në një grup politik.
3. Numri minimal për formimin e një grupi është 3(tre) këshilltarë.
4. Çdo grup paraqet pranë Kryetarit të Këshillit, listën me emrat e anëtarëve të grupit dhe atë të drejtuesit të grupit dhe ose n/ kryetarit të grupit, të firmosur nga anëtarët që formojnë grupin.
5. Çdo Këshilltar ka të drejtë të largohet nga një grup këshilltarësh, ose të kalojë në një grup tjetër këshilltarësh. Në këto raste këshilltari paraqet para Kryetarit të Këshillit, një njoftim me shkrim ku njofton largimin nga një grup këshilltarësh ose të kalimin në një grup tjetër.

KREU V.

KOMISIONET E KËSHILLIT

Neni 26

Komisionet e Këshillit

1. Këshilli Bashkiak, për kryerjen e funksioneve të tij, krijon Komisionet e Këshillit të cilat janë të Përhershëm ose të Përkohshëm dhe përbëhen nga këshilltarë bashkiakë.
2. Komisionet kryejnë detyra për njohjen dhe zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fusha të ndryshme të veprimtarisë së Këshilli Bashkiak.
3. Numri dhe përbërja e anëtarve të komisioneve, miratohet nga Këshilli me votim të hapur, me propozim të Kryetarit të Këshillit, pas konsultimeve me kryetarët e grupeve.
4. Një këshilltar nuk mund të jetë kryetar i më shumë se një Komisioni të Përhershëm.
5. Kryetari, Zv/Kryetari, dhe Sekretari i Këshillit, nuk bëjnë pjesë në përbërjen e komisioneve.
6. Një këshilltar mund të bëjë pjesë jo më shumë se në dy komisione të përhershme.

Neni 27

Komisionet e Përhershme të Këshillit

1. Komisioni Ekonomik dhe i Kontrollit- Financiar

2. Komisioni i Shërbimeve, Zhvillimit Urbanistik, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Strehimit
3. Komisioni Juridik dhe i Rendit
4. Komisioni i Arsim Kulturës, Sportit dhe Shëndetsisë
5. Komisioni për barazinë gjinore dhe përfshirjes sociale
6. Komisioni i verifikimit të mandateve
7. Komisioni i votimit
8. Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për statusin “Dëshmor i Atdheut.

Neni 28

Veprimtaria e Komisioneve të Përhershme të Këshillit

1. Veprimtaria e Komisioneve të Përhershme, bazohet në legjislacionin përkatës, në këte rregullore dhe në rregulloret e funksionimit të tyre.
2. Komisionet e Përhershme shqyrtojnë raporte, projekte, studime e relacione të Bashkisë, të ndërmarrjeve dhe institucioneve në varësi të saj dhe bëjnë vlerësimet përkatëse për to.
3. Komisionet e Përhershme mund të hartojnë edhe vetë p/vendime, rregullore dhe urdhëra të cilat shoqërohen me relacionet përkatëse, të cilat ja paraqesin Këshillit, por duke bashkëpunuar me administratën dhe titullarin e Bashkisë.
4. Komisionet e Përhershme, mund të organizojnë edhe mbledhje të përbashkëta midis tyre, të cilat drejtohen nga një kryetar i pranuar me bashkëpunim.
5. Nëpunësit e administratës së Bashkisë si dhe ato të ndërmarrjeve dhe institucioneve në varësi të saj, janë të detyruar t’iu vënë në dispozicion këshilltarëve të dhënat që kërkojnë në përputhje me legjislacionin përkatës dhe shpjegimet rreth p/vendime.
6. Të gjitha p/vendimet, si rregull duhet të diskutohen në komisionet e specializuara para se të shqyrtohen në Këshill.
7. Komisionet, gjatë veprimtarisë së tyre, për çështje të caktuara, mund t’i propozojnë Këshillit aktivizimin si ekspertë të specialistëve të jashtëm.
8. Raportimi në këshill në emër të komisionit bëhet nga kryetari i komisionitose anëtari i caktuar nga vetë komisioni. Kur komisioni nuk arrin të dalë në një raport konsensual në këshill, relatohet dhe mendimi ndryshe.

Neni 29

Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme

1. Komisionet e Përhershme mblidhen nga Kryetari ose zëvendësi i tij, me kërkesën e 1/3 të anëtarëve të komisionit dhe me porosi të Kryetarit të Këshillit
2. Mbledhja e një komisioni, është e vlefshme, kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
3. Mbledhjet e Komisioneve zhvillohen të hapura për publikun, përveç rasteve kur sipas ligjit dhe kësaj Rregulloreje, komisioni vendos që mbledhja të mbahet e mbyllur.
4. Komisioni pasi shqyrton dhe voton projekt-aktet e paraqitura, përgatit një relacion, të cilin Kryetari apo zëvendësi i tij, e paraqet në mbledhjen e Këshillit.

5. Projekt-akti konsiderohet i miratuar për të kaluar në mbledhjen e Këshillit, kur votohet "pro" nga shumica e këshilltarëve pjesëmarrës në mbledhje.
6. Këshilltarët që kanë votuar kundër, kanë të drejtë të shprehin mendimin e tyre në këtë mbledhje.
7. Komisionet e Përhershme mblidhen në selinë e Bashkisë, sipasnjë kalendari të përgatitur në bashkëpunim me Kryetarin dhe Sekretarin e Këshillit.
8. Këshilltarët, jo anëtarë të një komisioni, mund të marrin pjesë pa të drejtë vote, në mbledhjen e një komisioni tjetër.
9. Në mbledhjet e Komisioneve të Përhershme, mbahet protokoli nga Sekretari i Këshillit, i cili, pas verifikimit, nënshkruhet edhe nga drejtuesi i komisionit.

Neni 30

Komisionet e Përkohshme

1. Komisionet e Përkohshme krijohen nga Këshilli për një çështje të caktuar.
2. Këshilli miraton me vendim emrin, qëllimin, afatin kohor të funksionimit të tij dhe përbërjen e Komisionit dhe zgjedh Kryetarin e tij.
3. Mënyra e krijimit dhe funksionimit të Komisionit të Përkohshëm bëhet njëloj si me Komisionin e Përhershëm.
4. Kohëzgjatja e veprimtarisë, përcaktohet në aktin e krijimit të tyre por nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj.

Neni 31

Komisioni i Përzier

1. Komisioni i Përzier është komision i përhershëm apo përkohshëm i përbërë nga anëtarë dhe jo anëtarë të Këshillit, pjestarë të administratës së Bashkisë, që ngrihet nga Këshilli si organizëm këshillimor dhe mbikqyrës dhe ngrihet për një çështje të caktuar, dhe pushon së funksionuari me përfundimin e çështjes për të cilën është ngritur.
2. Ky komision miratohet nga Këshilli, duke përdorur të njëjtën procedurë që përdoret për miratimin e Komisioneve të Përhershme.
3. Mënyra e krijimit dhe funksionimit të Komisionit të Përzier është e njëjtë me atë të Komisionit të Përhershëm.

KREU VI.

PARAQITJA E PROJEKT- AKTEVE, DHE PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK

Neni 32

Seancat e këshillimeve me bashkësinë

1. Për probleme të caktuara, apo përpara shqyrtimit dhe miratimit të projekt-akteve, Këshilli, grupet dhe komisionet, zhvillojnë seanca këshillimi me bashkësinë.
2. Seancat e këshillimit janë të detyrueshme, për rastet e parashikuara në nenin 18,

shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k” të nenit 54, dhe 77, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, të ligjit “Për vetëqeverisjen Vendore”.

3. Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës që përcakton Këshilli, duke përdorur një nga format e nevojshme: si takimet e hapura me përfaqësues të banorëve, takime me specialist dhe institucione të interesuara dhe organizata jofitimprurëse, ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.
4. Problemet që dalin nga procesi i këshillimit, trajtohen në mbledhjet e komisioneve përkatëse dhe më pas në Këshillin Bashkiak.

Neni 33

E drejta e publikut për t’u informuar

1. Në varësi me mundësitë, aktet e Këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga Këshilli, brenda territorit të Bashkisë.
2. Informimi në Bashki, bëhet sipas rregullave që cakton Këshilli, bazuar në ligjin nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”.
3. Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara ngavetë këshilli përkatës për këtë qëllim.

Neni 34

Përgatitja dhe propozimi i projekt-akteve në Këshillin Bashkiak

1. Kanë të drejtë të përgatisin dhe propozojnë projekt-akte në Këshillin Bashkiak:
 - Kryetari i Bashkisë,
 - Kryetari i Këshillit,
 - Grupet e Këshilltarëve,
 - Komisionet e Përhershme,
 - Çdo Këshilltar,
 - Jo më pak se 1% e numrit të banorëve të Bashkisë (iniciativa qytqtare).
2. Propozimet dorëzohen zyrtarisht, të nënshkruara, në zyrën e protokoll/arkivit të Bashkisë.
3. Këto propozime para se ti paraqiten Këshillit, duhet të marrin konfirmimin e shprehur me shkrim për bazueshmërinë ligjore, nga drejtoria /sektori juridik i Bashkisë , përveç rasteve/propozimeve që kanë të bëjnë me dispozita të rregullores së Këshillit.
4. Për propozime/projektet me karakter financiar që ndikojnë në buxhetin e Bashkisë, duhet të merret më parë mendimi i organit egzekutiv, i cili duhet të shprehet brenda një muaji. Në rast mos shprehje brenda këtij afati, përgjigja konsiderohet pozitive.
5. Në rast refuzimi nga zyrtarët e mësipërm, materiali kalon për shqyrtim në mbledhjen e kryesisë së Këshillit, ku bëhet ballafaqimi mes propozuesit dhe zyrës në fjalë.
6. Në përputhje me rendin e ditës të miratuar, propozuesi i paraqet projekt/aktin Sekretarit të Këshillit, jo më vonë se 15 ditë përpara dates së mbledhjes së rradhës, të cilat regjistrohen në librin e akteve të Këshillit.

Neni 35

Propozimet e ardhura/paraqitura me iniciativë qytetare

1. Këto propozime mund të paraqiten nga jo më pak se 1% e numrit të banorëve të Bashkisë Poliçan, të cilat duhet të jenë në formë të shkruar dhe të përmbajnë:
 - a. propozuesin/it;
 - b. objektin që propozohet;
 - c. bazën ligjore të propozimit;
 - ç) arsyet e propozimit dhe efektet e pritshme të aktit;
 - d) materiale shtesë nëse ka.
2. Propozimi shoqërohet me listën e personave propozues, që përmban emër, atësi mbiemër, ID, nënshkrimin e tyre, nr. personal, adresën e përfaqësuesit.
3. Propozimi dorëzohet zyrtarisht, në zyrën e protokoll arkivit të Bashkisë.
4. Këto propozime para se ti paraqiten Këshillit, duhet të marrin konfirmimin e shprehur me shkrim për bazueshmërinë ligjore, nga drejtoria /sektori juridik i Bashkisë.
5. Kur këto propozime kanë ndikim financiar në buxhetin e Bashkisë, duhet të merret prapakisht mendimi me shkrim i Kryetarit të Bashkisë.

Neni 36

Mbledhjet e Këshillit

1. Mbledhjet e Këshillit janë të hapura për publikun. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e Këshillit në sallën e mbledhjeve, për aq sa lejojnë vendet për publikun në salle. Në mbledhjet e hapura lejohet transmetimi direkt i tyre nga mediat radiotelevizive.
2. Thirrja për mbledhjen e Këshillit, bëhet nga Kryetari i Këshillit dhe në mungesë të tij nga Zëvendëskryetari. Njoftimi për mbledhjen e Këshillit, bëhet si rregull, jo më pak se pesë (5) ditë para datës së zhvillimit të saj.
3. Njoftimi publik për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit bëhet nga Sekretari, në vendet të caktuara për këtë qëllim, në media, në faqen e internetit të Bashkisë dhe përmban datën, orën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes.
4. Me kërkesën e Kryetarit të Bashkisë ose 1/5 të anëtarëve të Këshillit, mbledhjet e Këshillit mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar "Pro", jo më pak se 3/5 e anëtarëve të tij.
5. Kryetari i Këshillit me ndihmën e Sekretarit, cakton vendet në sallë për Kryetarin e Bashkisë, administratën e Bashkisë, të ftuarit, median dhe publikun.
6. Kryetari dhe Sekretari i Këshillit, marrin masa për funksionimin e gjithë infrastrukturës, në mbështetje të një procesi transparent dhe kushte normale pune.

Neni 37

Mbledhjet jashtë radhe

1. Këshilli mbledhet jashtë radhe me kërkesë të:

- a) Penguar zbulimin e një informacioni konfidencial (jo publik), i përcaktuar si i tillë me ligj;
 - b) Shqyrtuar fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së Këshillit;
 - c) Shqyrtuar çështje konflikte mes banorëve;
 - ç) Shqyrtuar ankesa kundrejt Këshilltarëve, Kryetarit, Sekretarit apo stafit të Bashkisë;
 - d) Planifikuar, raportuar apo dëgjuar raporte që kanë lidhje me hetime të sjelljeve kriminale;
 - dh) Penguar daljen e parakohshme të informacionit për një titull honorifik, apo çmim;
 - e) Thyerje të Kodit të Sjelljes apo Etikës nga Këshilltarët;
2. Vendimet që merren në një Mbledhje të Mbyllur bëhen publike.
 3. Persona jo Këshilltarë mund të lejohen të marrin pjesë në një Mbledhje të Mbyllur nëse ata ndihmojnë në shqyrtimin e çështjes/ve dhe kur për këtë vendos shumica e Këshilltarëve të pranishëm në mbledhje.
 4. Sekretari ruan konfidencialitetin e mbledhjeve të mbyllura të Këshillit dhe çdo shkelje e këtij detyrimi përbën shkak për masë disiplinore ndaj tij.

Neni 40 Mbajtja e Mbledhjes

1. Në orën e caktuar për hapjen e mbledhjes, Kryetari i Këshillit me ndihmën e Sekretarit të Këshillit, procedon me verifikimin e numrit të Këshilltarëve të pranishëm në mbledhje.
2. Kurdoherë që Kryetari verifikon se shumica e domosdoshme nuk është e pranishme, mund të urdhërojë Sekretarin t'u kërkojë këshilltarëve mungues të jenë të pranishëm në mbledhje. Ky urdhër merret pa debat dhe derisa shumica e domosdoshme të jenë të pranishëm, asnjë propozim nuk do të jetë në rendin e ditës përveç kur bëhet fjalë për shtyrje të mbledhjes.
3. Kur edhe pas këtyre veprimeve nuk sigurohet kuorumi i nevojshëm, Kryetari vendos shtyrjen e mbledhjes, **të paktën 24 orë**.
4. Kryetari deklaron hapjen e mbledhjes, nëse kuorumi është i pranishëm, gjë të cilën i'a konfirmon Sekretari.

Neni 41 Procedura e zhvillimit të mbledhjeve

1. Kryetari i Këshillit, pas verifikimit të pjesëmarrjes nga sekretaria, deklaron hapjen e mbledhjes, komunikon rendin e ditës dhe paraqet për votim propozimet për ndryshime të mundshme të tij, duke miratuar rendin e ditës.
2. Në një mbledhje të rrregullt (apo jashtë radhe), para miratimit të rendit të ditës, Kryetari i Bashkisë apo çdo këshilltar, mund të propozojë të shtohet një çështje në rendin e ditës. Ky propozim duhet të jetë me shkrim. Për këtë propozim fillimisht duhet të japë mendimin e tij, edhe verbal, komisioni/et të cilit i përket çështja. Kur propozimi ka ndikim financiar në buxhetin e Bashkisë, duhet të japë mendimin dhe Kryetari i Bashkisë. Ky propozim mund të shtohet në rendin e ditës, vetëm nëse për këtë votojnë "Pro", shumica e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

- a) Kryetarit të Bashkisë;
 - b) 1/3 së Këshilltarëve;
 - c) kërkesës së motivuar të Prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.
2. Në secilin prej rasteve të mësipërme, Kryetarit të Këshillit duhet t'i paraqitet me shkrim kërkesa për mbajtjen e mbledhjes jashtë radhe, ku specifikohet qartë çështja, qëllimi dhe arsyet e kërkesës për mbajtjen e mbledhjes.
 3. Mbledhja jashtë radhe mbahet jo më vonë se dhjetë (10) ditë, nga data e njoftimit zyrtarisht nga zyra e protokollit, të kërkesës nga autoriteti i përshkruar më sipër.
 4. Data dhe ora e mbledhjes caktohet nga Kryetari i Këshillit pas konsultimit me kryesinë e Këshillit.
 5. Njoftimi për Këshilltarët bëhet nga Sekretari, dhe në mungesë të tij nga Kryetari apo Zëvendëskryetari, me telefon apo njoftim gojor direkt, dhe e-mail. Ky njoftim bëhet së paku 48 orë para mbajtjes së mbledhjes dhe përfshin datën, orën, vendin, rendin e ditës, çështjet dhe qëllimin për të cilin mbahet mbledhja, dhe në njoftim specifikohet se kush e ka kërkuar mbledhjen jashtë radhe.
 6. Në mbledhjen jashtë radhe shqyrtohen vetëm ato çështje për të cilat është thirrur mbledhja. Çështje të tjera mund të diskutohen vetëm më miratimin e shumicës së Këshilltarëve të pranishëm në mbledhje.

Neni 38

Njoftimi i Mbledhjes

1. Njoftimi për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit bëhet nga Sekretari, me e-mail, me postë, me telefon apo njoftim gojor direkt. Njoftimi për Këshilltarët, bëhet si rregull, jo më pak se pesë (5) ditë para datës së zhvillimit të saj. Në mungesë të Sekretarit njoftimi bëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari apo një person i ngarkuar prej tyre. Kur në rend të ditës janë çështje të tilla si buxheti apo paketa fiskale, njoftimi për Këshilltarët, bëhet jo më pak se pesë (5) ditë para datës mbledhjes.
2. Njoftimi për publikun bëhet nga Sekretari, dhe në mungesë të tij nga Kryetari apo Zëvendëskryetari, në median vendore, në tabelën informative të Bashkisë, dhe në faqen e internetit të Bashkisë. Sekretari njofton të gjitha ato subjekte, të cilat kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt për çdo mbledhje Këshilli.
3. Këshilltarët pajisen nga sekretari me paketën e rendit, duke i'a dorëzuar çdo këshilltarime e-mail, me postë ose dorazi.
4. Paketa e projekt-rendit të ditës, përmban dokumentat e rendit të ditës, çdo projekt-vendim apo projekt-ndryshim vendimi, relacion përkatës, grafikun e mbledhjeve të komisioneve, dhe çdo dokumentacion mbështetës që ka lidhje me çështjet e rendit të ditës.

Neni 39

Mbledhja e Mbyllur

1. Këshilli mund të mbajë një Mbledhje të Mbyllur kur kjo kërkohet për të:

- a) Penguar zbulimin e një informacioni konfidencial (jo publik), i përcaktuar si i tillë me ligj;
 - b) Shqyrtuar fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së Këshillit;
 - c) Shqyrtuar çështje konflikte mes banorëve;
 - ç) Shqyrtuar ankesa kundrejt Këshilltarëve, Kryetarit, Sekretarit apo stafit të Bashkisë;
 - d) Planifikuar, raportuar apo dëgjuar raporte që kanë lidhje me hetime të sjelljeve kriminale;
 - dh) Penguar daljen e parakohshme të informacionit për një titull honorifik, apo çmim;
 - e) Thyerje te Kodit te Sjelljes apo Etikës nga Këshilltarët;
2. Vendimet që merren në një Mbledhje të Mbyllur bëhen publike.
 3. Persona jo Këshilltarë mund të lejohen të marrin pjesë në një Mbledhje të Mbyllur nëse ata ndihmojnë në shqyrtimin e çështjes/ve dhe kur për këtë vendos shumica e Këshilltarëve të pranishëm në mbledhje.
 4. Sekretari ruan konfidencialitetin e mbledhjeve të mbyllura të Këshillit dhe çdo shkleje e këtij detyrimi përbën shkak për masë disiplinore ndaj tij.

Neni 40

Mbajtja e Mbledhjes

1. Në orën e caktuar për hapjen e mbledhjes, Kryetari i Këshillit me ndihmën e Sekretarit të Këshillit, procedon me verifikimin e numrit të Këshilltarëve të pranishëm në mbledhje.
2. Kurdoherë që Kryetari verifikon se shumica e domosdoshme nuk është e pranishme, mund të urdhërojë Sekretarin t'u kërkojë këshilltarëve mungues të jenë të pranishëm në mbledhje. Ky urdhër merret pa debat dhe derisa shumica e domosdoshme të jenë të pranishëm, asnjë propozim nuk do të jetë në rendin e ditës përveç kur bëhet fjalë për shtyrje të mbledhjes.
3. Kur edhe pas këtyre veprimeve nuk sigurohet kuorumi i nevojshëm, Kryetari vendos shtyrjen e mbledhjes, **të paktën 24 orë**.
4. Kryetari deklaron hapjen e mbledhjes, nëse kuorumi është i pranishëm, gjë të cilën i'a konfirmon Sekretari.

Neni 41

Procedura e zhvillimit të mbledhjeve

1. Kryetari i Këshillit, pas verifikimit të pjesëmarrjes nga sekretaria, deklaron hapjen e mbledhjes, komunikon rendin e ditës dhe paraqet për votim propozimet për ndryshime të mundshme të tij, duke miratuar rendin e ditës.
2. Në një mbledhje të rrregullt (apo jashtë radhe), para miratimit të rendit të ditës, Kryetari i Bashkisë apo çdo këshilltar, mund të propozojë të shtohet një çështje në rendin e ditës. Ky propozim duhet të jetë me shkrim. Për këtë propozim fillimisht duhet të japë mendimin e tij, edhe verbal, komisioni/et të cilit i përket çështja. Kur propozimi ka ndikim financiar në buxhetin e Bashkisë, duhet të japë mendimin dhe Kryetari i Bashkisë. Ky propozim mund të shtohet në rendin e ditës, vetëm nëse për këtë votojnë "Pro", shumica e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

3. Për të siguruar një ecuri normale dhe efektive të mbledhjeve të Këshillit, ndiqet kjo procedure:
- Shprehet mendimi i komisionit të përhershëm, për projekt –aktin e paraqitur.
 - Drejtohen pyetje nga këshilltarët.
 - U jepet përgjigje, pyetjeve të këshilltarëve.
 - Diskutime nga këshilltarët.
 - Shprehen mendimet e drejtuesve të grupeve të këshilltarëve.
 - Votohen propozimet për ndryshime të mundshme në projekt, sipas radhës së paraqitjes së tyre.
 - Kryehet votim i hapur ose i fshehtë, sipas vendimit që ka marrë vetë Këshilli.

Neni 42 **Radha e diskutimeve**

1. Këshilltari fillon diskutimin, pasi i jepet fjala nga Kryesuesi i Mbledhjes.
2. Këshilltari e kërkon fjalën, me ngritjen e dorës ose me shkrim.
3. Këshilltari diskuton vetëm një herë për problemin që shqyrtohet.
4. Kryetari i Këshillit, përcakton radhën e diskutimeve, duke mbajtur parasysh kohën e kërkesës, si dhe mundësinë e fjalës nga grupet e ndryshme të Këshilltarëve.
5. Kryetarët e grupeve kanë të drejtë të diskutojnë jashtë rradhe, në rast se e kërkojnë fjalën.
6. Këshilltari kur i jepet e drejta e fjalës nga Kryesuesi i Mbledhjes, mund të flasë në këmbë ose ulur, sipas zgjedhjes së tij.
7. Këshilltarit mund t'i ndërpritet diskutimi, kur nuk i përmbahet rregullave të etikës, pasi është paralajmëruar.

Neni 43 **Çështjet e proceduriale**

1. Për çështje të procedurës fjala jepet menjëherë.
2. Janë çështje të procedurës:
 - a. kërkesat që kanë të bëjnë me zbatimin e Rregullores,
 - b. kërkesat për ndërprerjen ose shtyrjen e seancës ose të diskutimeve,
 - c. kërkesat që kanë të bëjnë me mënyrën e marrjes së vendimeve ose kryerjes së votimit.
3. Ndërhyrjet për çështjet e procedurës bëhen shkurtimisht dhe pa prekur thelbin e çështjes kryesore. Në këto raste, përveç propozuesit që diskuton jo më shumë se 2 minuta, kanë të drejtë të diskutojnë një folës Pro dhe një folës Kundër, jo më shumë se 2 minuta secili.
4. Këshilltarit i ndërpritet fjala kur nuk respekton kërkesat e mësipërme.

Neni 44 **Kohëzgjatja e diskutimeve**

1. Këshilli vendos si rregull një kohëzgjatje të caktuar për çdo diskutim në fillim të seancës, e cila duhet të respektohet nga Këshilltarët që e marrin fjalën.

Këshilltari lajmërohet për përfundimin e diskutimit, një minute para mbarimit të kohës së diskutimit.

2. Në rast se diskutanti e tejkalon atë, ai paralajmërohet nga drejtuesi i séances për ta përfunduar dhe nëse ai vazhdon, i hiqet e drejta e fjalës.
3. Diskutanti paralajmërohet nga drejtuesi i seancë edhe kur ai shmanget nga tema kryesore e diskutimit. Diskutantit i hiqet e drejta e fjalës, vetëm për atë problem të rendit të ditës, nëse kjo shkelje vazhdon.
4. Një Këshilltar mund të shfrytëzojë kohën e kolegut, me kusht që të ketë qënë regjistruar më parë për diskutim dhe kur shprehen publikisht në mbledhje.
5. Kryetari dhe zv/Kryetari i Bashkisë, drejtuesit dhe Këshilltarët e ngarkuar për të folur, në emër të grupeve, mund të marrin fjalën për diskutim sa here që e kërkojnë.

Neni 45

Replika gjatë diskutimeve

1. Këshilltari ka të drejtën e replikës, në rast se i përmendet emri në diskutimin e prafolësit.
2. Replika është një qëndrim i paraqitur në mënyrë të shkurtër, për përmbajtjen e problemit që është në diskutim.
3. Replika mbahet menjëherë, pas diskutimit dhe nuk mund të vazhdojë më shumë se 2 minuta.
4. Pas replikës, nuk ka kundër-replikë.

Neni 46

Ndërprerja apo mbyllja e diskutimeve

1. Kryetari i Këshillit, shpall mbylljen e diskutimeve, nëse lista emërore e diskutantëve ka përfunduar.
2. Këshilltarët mund të heqin dorë nga diskutimi në çdo kohë, në rastë se e çmojnë të arsyeshme.
3. Mungesa në sallën e mbledhjeve, në çastin e radhës për diskutim, konsiderohet heqje dorë nga diskutimi.
4. Këshilltarët mund të kërkojnë mbylljen e diskutimeve me mirëkuptim.
5. Këshilltari i listës emërore, nuk mund të pengohet të diskutojë, në rastë se nuk shpreh mirëkuptimin për mbylljen e tyre.
6. Nëse pranohet propozimi për ndërprerjen e diskutimeve, fjala i jepet drejtuesve të grupeve, të cilët dëshirojnë të diskutojnë.
7. Propozimet si rregull, hidhen në votim sipas radhës së depozitimit të tyre.

Neni 47

Rregulli në Mbledhjet e Këshillit

1. Në sallën e mbledhjeve marrin pjesë në cilësinë e të ftuarit, vetëm personat e autorizuar nga kryesia e Këshillit.

2. Pjesëmarrësit në mbledhjen e Këshillit, qëndrojnë në vendet e caktuara për ta dhe respektojnë rregullat e mbledhjes.
3. Kryetari mund të ndërpresë mbledhjen në rastet kur prishet rregulli i vendosur, ose pengohet ecuria normale e mbledhjes së Këshillit. Në rast përsëritjeje, me propozim të Kryetarit ose të një grupi këshilltarësh, mbledhja shtyhet për një herë tjetër.

Neni 48

Votimi në Mbledhjen e Këshillit

1. Këshilltarët votojnë në mënyrë individuale. Këshilltari nuk mund të delegojë të drejtën e votës.
2. Votimi në Mbledhjen e Këshillit, mund të bëhet i hapur apo i fshehtë, sipas vendimit që merr Këshilli.
3. Proçesi i votimeve të akteve me karakter individual, klryehet si rregull me votim të fshehtë.
4. Proçedura e votimit të fshehtë, organizohet nga një komision i përbërë nga 3-5 këshilltarë të zgjedhur, me votim të hapur nga Këshilli.
5. Vendimet e Këshillit, kur nuk përcaktohen ndryshe në ligj, merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
6. Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat "a", "b", "c", "d", "dh", "f", "g", "gj", "i" dhe "j", të nenit 54, të ligjit "Për vetëqeverisjen Vendore".
7. Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën "e", të nenit 54, të këtij ligji.
8. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendës-kryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave. Në këtë rast fitues shpallet kandidati që ka numrin më madh të votave dhe, nëse votat janë të barabarta, fituesi caktohet me short.
9. Këshilltarët që kanë konflikt interesash në lidhje me aktin që miratohet, nuk marrin pjesë në votim ose abstenojnë, duke deklaruar votën dhe arsyet e abstenimit.
10. Në fund të votimit shpallet rezultati nga Kryetari i Këshillit me formulën "*Këshilli miraton aktin*" ose "*Këshilli nuk miraton aktin*".
11. Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
12. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.
13. Votimi i Këshilltarit me telefon apo nëpërmjet video konferencës nuk lejohet përveç në rastet e emergjencës civile të shpallur zyrtarisht dhe sipas kërkesave ligjore dhe procedurës së kësaj Rregullore.

Neni 49

Rezultatet e Votimit

1. Projektet në Këshillin Bashkiak quhen të miratuara, kur ato përputhen me rregullin dhe proçedurën e nenit 55 të ligjit "Për vetëqeverisjen Vendore".
2. Kryetari i Bashkisë zbaton aktet e këshillit.
3. Kryetari i Bashkisë, merr masa për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve për këshillin bashkiak, në përputhje me rendin e ditës së përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme që kërkon ai vetë;

4. Kryetari i Bashkisë, raporton në Këshill për gjendjen ekonomiko-financiare të bashkisë dhe njërive administrative përbërëse të paktën çdo 6 muaj ose sa herë kërkohet nga këshilli;
5. Kryetari i Bashkisë, merr të gjitha masat për prezencën e punonjësve të aparatit të Bashkisë në mbledhjet e Këshillit.
6. Kryetari i Bashkisë, raporton para Këshillit, sa here kërkohet prej tij , për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e Bashkisë.
7. Kryetari i Bashkisë, i kthen për rishqyrtim, jo më shumë se një herë në Këshill vendime, që kanë të bëjnë me funksione të bashkisë.
8. Kryetari i Bashkisë, u përgjigjet pyetjeve që i drejtojnë këshilltarët gjatë raportimit, apo organizimit të seancave të veçanta.
9. Pyetjet që i drejtohen Kryetarit të Bashkisë, duhet të jenë të shkurtra dhe të kenë të përcaktuar qartë, çështjet për të cilat kërkohet informacion.
10. Këshilltari që bën pyetjen, ka të drejtën gjithashtu që të përcaktojë , nëse përgjigjet i do me shkrim apo me gojë.
11. Pyetjet që kërkohet kohë për nxjerje të dhënash, bëhen 5 ditë para dhe formulohen me shkrim. Në të kundërt Kryetari i Bashkisë, ka të drejtën të kërkojë kohën e duhur për përgatitjen e përgjigjeve.
12. Përpara se të fillohet me përgjigjet, këshilltari që ka drejtuar pyetjet, mund të sqarojë ndonjë çështje që lidhet me arsyet e pyetjeve të bëra.
13. Gjatë përgjigjeve të pyetjeve, nuk lejohet të bëhet debat.
14. Këshilltari që ka bërë pyetjet dhe ka marrë përgjigje, ka të drejtë të diskutojë deri në 2 minuta, duke dhënë konsideratën e tij për to.
15. Kur Këshilltari që ka bërë pyetjet, tërhiqet nga mendimi i mëparshëm, këtë e deklaron me shkrim në Kryesinë e Këshillit, para zhvillimit të mbledhjes.

Neni 50

Proces-verbali i mbledhjes të Këshillit Bashkiak

1. Proces-verbali i mbledhjes së Këshillit përmban pikat kryesore të diskutimeve, mënyrat dhe procedurat e votimit, numrin e votave pro, kundra dhe abstenim: datën , orën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes si dhe emri dhe mbiemri i Këshilltarëve të pranishëm. Në fund, pasi proces-verbali kontrollohet, firmoset nga Kryetari i seancës, Sekretari dhe së paku nga 3 këshilltarë. (*Variant: Shumica e këshilltarëve të pranishëm në mbledhje firmosin Proces-verbalin e Mbledhjes*).
2. Proces-verbali mbahet nga specialisti i arkivës/protokollit, i cili e nënshkruan atë.
3. Zbardhja e akteve bëhet në mënyrë shkresore, format A4, bazuar në proces-verbalin e mbledhjes. Akti zbardhet në momentin kur firmoset nga Kryetari i Këshillit.
4. Në mungesë të titullarit të Këshillit, aktet zyrtare firmosen nga personi i autorizuar me shkrim prej tij. Në këtë rastë, në aktin zyrtar vihet shënimi "*në mungesë dhe me porosi*".

Neni 51

Etika dhe rregulli gjatë mbledhjes (sanksionet)

1. Këshilltari sillet me respekt në Mbledhjen e Këshillit dhe respekton Këshilltarët apo të pranishmit e tjerë në Mbledhjet e Këshillit apo Komisioneve të Përhershëm, pa përdorur fjalë fyese ose ofenduese.

2. Ndalohet kategorikisht pirja e duhanit dhe e pijeve alkoolike në sallën e mbledhjes së Këshillit dhe në mbledhjet e Komisioneve të Përhershme.
3. Të pranishmit në sallën e mbledhjeve nuk mund të flasin pa iu dhënë fjala.
4. Personit që i jepet fjala mund të falsë në tribunë ose nga vendi (i ngritur ose jo në këmbë).
5. Nuk lejohet përdorimi i celularve me volum të lartë.
6. Kryetari i Këshillit mund të caktojë punonjës të Bashkisë (policisë Bashkiake), për të siguruar rendin dhe qetësinë gjatë zhvillimit të mbledhjeve.
7. Kryetari i Këshillit mund të urdhërojë që persona të caktuar (jo këshilltarë) që prishin rregullin e zhvillimit të mbledhjeve, të dalin jashtë.
8. Këshilltari, i cili përdor fjalë jashtë etike, përdor fjalë fyese ose ofenduese, pengon me sjelljen e tij zhvillimin normal të mbledhjes, i tërhiqet vëmëndja nga Kryetari.
9. Kur Këshilltari e përsërit veprimin, Kryetari urdhëron dhe i kërkon të dale jashtë salle.
10. Kur Këshilltari refuzon të dalë, Kryetari ndërpret seancën dhe mbledh kryesinë për shqyrtimin e rastit.
11. Për ofendime të kolegeve, për prishje të atmosferës dhe ecurisë normale të mbledhjes, kryesia e Këshillit jep masën për përjashtimin të mos-pjesëmarrjes në 2-3 mbledhje të Këshillit.
12. Personit që i jepet fjala drejtohet me fjalët: I nderuar z./znj Kryetar/e, i nderuar z. drejtues i mbledhjes, i nderuar z. Këshilltar/ mbiemri.

Neni 52

Sjellja e publikut

1. Publiku i lejuar të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit, duhet të qëndroj në hapësirën e sallës të rezervuar për këtë qëllim, të mbajë qëndrim korrekt, të mos jap asnjë mendim për çështje në diskutim nga Këshilli, opinionet e shprehura nga Këshilltarët apo vendimet e Këshillit.
2. Kur sjellja e publikut pengon vazhdimin normal të mbledhjes, Kryetari urdhëron policinë Bashkiake, të largojë nga salla personat që sjellin shqetësim. Kur ka shqetësime të rënda të rendit publik, me shkrim të motivuar të shumicës së këshilltarëve, i cili pasqyrohet në proces-verbal, mbledhja vazhdon me dyer të mbyllura.

Neni 53

Mbledhja e Jashtëzakonshme

1. Mbledhja e Jashtëzakonshme është mbledhje jashtë radhe dhe mbahet në situata të emergjencës civile, si fatkeqësi natyrore, mungesë në masë të madhe të rendit dhe qetësisë publike në komunitet, apo raste të tjera të specifikuara me ligj, dhe që kërkojnë vendimmarrje urgjente të Këshillit. Në rast të emergjencave shëndetësore ato janë të mbyllura për pjesëmarrje fizike të publikut, dhe Këshilltarët respektojnë kërkesat ligjore për situatën e emergjencës dhe masat e jashtëzakonshme.

2. Mbledhja thirret nga Kryetari i Këshillit, mbi bazë të kërkesës së bërë me shkrim nga, më së paku, një e treta (1/3) e numrit të përgjithshëm të Këshilltarëve Bashkiakë apo me kërkesë, Kryetarit të Bashkisë, si dhe me kërkesën e motivuar të Prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të Prefektit. Kërkesa për mbajtjen e Mbledhjes duhet të specifikojë shkurtimisht natyrën dhe objektin e çështjes emergjente për shqyrtimin e së cilës kërkohet të mbahet Mbledhja.
3. Në Mbledhje Këshilli shqyrton vetëm çështjet për të cilat është thirrur Mbledhja, dhe pikat e caktuara në rendin e ditës dhe të njoftuara Këshilltarëve nuk mund të ndryshohen gjatë Mbledhjes.
4. Asnjë urdhër, urdhëresë apo vendim apo rezolutë nuk do të merret në konsideratë në Mbledhjen e Jashtëzakonshme përveç nëse është me shkrim dhe nëse nuk është paraqitur një kopje origjinale pranë Sekretarit apo Kryetarit të Këshillit.
5. Mbledhja e Jashtëzakonshme mund të mbahet në një vend tjetër nga Dhomat e Mbledhjeve të Këshillit, por në çdo rast mbrënda territorit të Bashkisë, përveç kur rrethane ekstreme e pengojnë këtë gjë, me kusht që Mbledhja të jetë e hapur për publikun.
6. Mbledhja e Jashtëzakonshme mbahet jo më vonë se 24 orë nga njoftimi i Mbledhjes për Këshilltarët apo depozitimi i kërkesës me shkrim për mbajtjen e Mbledhjes. Në Mbledhje Këshilli mund të ratifikojë udhëra apo vendime të Kryetarit të Bashkisë të marra për përballimin e situatës së jashtëzakonshme.
7. Njoftimi i Këshilltarëve bëhet nga Sekretari dhe në mungesë të tij nga vetë Kryetari i Këshilli apo nga Zevëndëskryetarët e Këshillit, me telefon apo mjete të tjera të njoftimit, apo njoftim gojor direkt. Personi që ka bërë njoftimin, Sekretari apo personi i autorizuar nga Kryetari, e informon Këshillin për mënyrën e njoftimit dhe emrat e Këshilltarëve të njoftuar. Mbledhja e Jashtëzakonshme nuk mbahet nëse të gjithë anëtarët e Këshillit nuk janë njoftuar, përveç kur një Këshilltar është i pamundur të njoftohet, dhe nuk është bërë njoftim publik i mbledhjes, sipas kërkesave të kësaj rregullore, së paku njëzet e katër (24) orë para mbajtjes së Mbledhjes. Rendi i ditës dhe dokumentet e Mbledhjes i përcillen Këshilltarëve me telefon celular (nëpërmjet whatsapp apo tjetër) dhe me email.
8. Në rast se Kryetari, Zevëndëskryetarët dhe Sekretari i Këshillit nuk mund të jenë të pranishëm në Mbledhjen e Jashtëzakonshme, Mbledhja kryesohet nga Këshilltari më i vjetër në moshë që përfaqëson shumicën politike në Këshill, i pranishëm në Mbledhje, dhe procesverbali i Mbledhjes nënshkruhet nga shumica e Këshilltarëve të pranishëm, si dhe vendimi/et e Këshillit zbardhen nga minimumi tre Këshilltarë dhe nënshkruhet/n nga kryesuesi i Mbledhjes.
9. Sekretari bën njoftimi për publikun në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë, në median televizive vendore, në tabelën informative jashtë dhe afër ndërtesës kryesore të Bashkisë, gjithësesi dhe sipas mundësive përdor një apo më shumë nga këto tre mënyra njoftimi. Sekretari njofton të gjithë ato persona apo organizata të cilat kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt për çdo mbledhje të Këshillit, duke i dërguar me email njoftimin dhe rendin e ditës së Mbledhjes së Këshillit. Njoftimi i Mbledhjes së Jashtëzakonshme të realizuar me mjete elektronike përfshin një përshkrim të mënyrës se si do të zhvillohet Mbledhja, si dhe vendin dhe mënyrë që publiku të mund të marrë pjesë për të dëgjuar pjesët e mbledhjes që janë të hapura për publikun.
10. Në rastin mbajtjes së Mbledhjes së Jashtëzakonshme aktet e Këshillit shpallen publikisht dhe hyjnë në fuqi sipas specifikimit të bërë në tekstin e vendimit të Këshillit.
11. Anëtarët e Këshillit mund të marrin pjesë dhe të jenë të pranishëm nëpërmjet mjeteve elektronike në një Mbledhjen së Jashtëzakonshme të Këshillit, me anë të telefonisë celulare,

mjeteve transmetuese me video, sistemit kompjuterik apo paisjeve dhe programe të tjera të medias së komunikimit elektronik, të cilat lejon transmetimin e videos dhe zërit të Këshilltarëve, e që quhet mbledhje elektronike, me kusht që:

- a. Ekziston një emergjencë e tillë që mos lejimi i pjesëmarrjes së anëtarëve të Këshillit Bashkiak në mbledhje përmes komunikimit elektronik do të rrezikonte interesin publik, shëndetin, sigurinë ose mirëqenien e qytetarëve,
- b. Para fillimit të mbledhjes, Sekretari, apo në mungesë të tij Kryetari i Këshillit, apo zëvendëskryetari do të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të njoftuar të gjithë anëtarët e Këshillit, të cilët pritet të mos jenë në gjendje të jenë fizikisht të pranishëm në vendin e mbledhjes, në mënyrë që t'u japin atyre një mundësi për të marrë pjesë nëpërmjet komunikimit elektronik,
- c. Këshilltarët të jenë në komunikim të drejtpërdrejtë, të mund të shohin dhe të dëgjojnë njëri tjetrin njëherazi dhe përgjatë gjithë mbledhjes nëpërmjet paisjeve elektronike,
- d. Publiku të ketë mundësi të shohi dhe të dëgjojë Mbledhjen e Këshillit nëpërmjet paisjeve elektronike dhe faqes së internetit, të dëgjojë diskutimin dhe votimin e Këshilltarëve.
- e. Publiku të ketë qasje elektronike në Mbledhjen e Këshillit, për komente apo dëgjesa publike, kryesisht me email.

12. Të gjithë anëtarët e Këshillit apo zyrtarët dhe personeli i Bashkisë apo të tjerë, pjesëmarrës në mbledhjen elektronike, duhet të identifikojnë veten e tyre dhe tu jepet fjala nga Kryesuesi para se të flasim.

13. Minimumi një prej anëtarëve të Këshillit duhet të jetë i pranishëm në vendin e caktuar të mbledhjes të identifikuar në njoftimin publik si mbledhje elektronike, përveç se kur masat e jashtëzakonshme nuk e lejojnë një gjë të tillë.

14. Mbledhje hapet nga Kryetari/ Kryesuesi, i cili deklaron kuorumin.

15. Me fillimin e mbledhjes, Këshilli bën një procesverbal të rrethanave që përbëjnë urgjencën që kërkon përdorimin e komunikimit elektronik, dhe të arsyeve të mbajtjes së mbledhjes në një vend ndryshe nga dhoma e mbledhjeve të Këshillit, si dhe një procesverbal të natyrës dhe shtrirjes së përpjekjeve të bëra për t'i dhënë secilit anëtar të Këshillit që nuk merr pjesë elektronikisht, një mundësi për të marrë pjesë me mjete të komunikimit elektronik, si dhe justifikimin e kohës së njoftimit të mbledhjes. Pas bërjes së këtij procesverbali, Këshilli do t'u japë një mundësi të gjithë atyre që janë në komunikimit elektronik me mbledhjen të shprehin çdo kundërshtim që ata kanë për të kryer mbledhjen përmes komunikimit elektronik.

16. Nëse lidhja e komunikimit të një apo disa Këshilltarëve ndërpritet gjatë Mbledhjes Elektronike:

- a. Kryetari / Kryesuesi kërkon një pushim prej 10 minutash për të rivendosur lidhjen/et,
- b. nëse pas ndërprerjes, një apo disa lidhje nuk mund të rivendoset, anëtarë/rët e Këshillit që i ishte ndërprerë lidhja do të konsiderohet se ka lënë Mbledhjen.
- c. nëse pas ndërprerjes një apo disa lidhje nuk mund të rivendoset dhe nuk ka një kuorum të anëtarëve të Këshillit, Kryetari / Kryesuesi deklaron mbylljen dhe shtyrjen e Mbledhjes deri në një njoftim të radhës.

17. Votimi në mbledhjet e jashtëzakonshme dhe elektronike, për vendimmarrje që kanë të bëjnë me çështje të situatës emergjente, bëhet i hapur dhe me zë, dhe kjo regjistrohet në procesverbalin e Mbledhjes.
18. Kostot për pjesëmarrjen e Këshilltarëve në Mbledhjen Elektronike mbulohen nga Bashkia.

Neni 54
Shfuqizime

Çdo rregullore e mëparshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak të shfuqizohet.

KREU VII.
DISPOZITA E FUNDIT

Neni 55

Ndryshimi i Rregullores, miratimi dhe Hyrja në fuqi

1. Kryetari i Këshillit, një kryetar grupi, një komision i përhershëm apo 1/3 e anëtarëve të Këshillit, kanë të drejtë të paraqesin propozime për ndryshimin e kësaj rregulloreje.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi, në datën e miratimit në Këshill dhe pasi është konfirmuar ligjshmëria nga Prefektura e Qarkut Berat.
3. Kjo rregullore përbëhet nga 55 (pesëdhjetëpesë) nene dhe ka në total 27 fletë.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Mimoza Lulaj

(emër, mbiemër, firmë)

